

**AKTI I THEMELIMIT**  
**I**  
**SHOQERISE TREGTARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**“ÇETINKAYA” sh.p.k**

Themeluesit qe nenshkruajne me poshte jane si vijon:

**Z. Sahin Tasci**, i datelindjes 20.05.1983, i biri i Hatip-it, lindur ne Izmir/Turqi dhe banues ne Bayindir, Izmir/Turqi, identifikuar me pasaport Turke nr. U32520659 dhe nr personal turk 60238201068 madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar,

**Z. Ramazan Çavur**, i datelindjes 25.06.1983, i biri i Mehmet-it, lindur ne Sanliurfa/Turqi dhe banues ne Bayindir, Izmir/Turqi identifikuar me pasaport Turke nr. U32520669 dhe nr personal turk 34415271052 madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar,

**Qe ne vijim do te quhen Ortaket e Shoqerise “ÇETINKAYA” sh.p.k**

Sot me date **30.01.2024**, bazuar ne vullnetin e tyre te lire dhe ne perputhje me ligjin Nr.9901 date 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, vendosen te themellojne Shoqerine Tregtare me Pergjegjesi te Kufizuar, ne baze te kushteve qe vijojne:

**Kreu I**

**OBJEKTI, EMERTIMI, SELIA, REGJIMI JURIDIK**

**Neni 1**

**Objekti i shoqerise**

Shoqeria Tregtare “ÇETINKAYA” sh.p.k, ka si objekt veprimtarie:

Hapja dhe menaxhimi i restoranteve, te bareve, dhe sherbim i ushqimit katering. Tregti me pakice te artikujve te ndryshem si; industrial, produkteve ushqimore, kozmetikes, estetikes dhe te veshjeve. Sherbime dhe konsulenca ne turizem, tregti nderkombetare dhe ne fushen e agro-turizem. Shit-blerje te makinerive apo mjeteve motorrike per perdorim tregtar, marrja apo dhenja e tyre me qira. Blerje pasuri te luajtshme apo te paluajtshme, t’i marre ose t’i leshoje me qera. Mund te vendose pasuri te luajtshme dhe te paluajtshme, t’a hipotekoje kete pasuri ne rregjistrin e pasurive te paluajtshme ne emer te saj.

**Neni 2**

**Emertimi dhe Selia Juridike e Shoqerise**


Ortaket vendosen qe shoqerine ta emertojne “ÇETINKAYA” sh.p.k

Selia juridike e Shoqerise ndodhet ne Njësia Administrative Nr.5, Bulevardi Bajram Curri, Nd.116, H.28, Ap.4; Kodi Postar 1019, Tirane

Shoqeria mund te krijoje qendra sekondare, filiale, zyra perfaqesimi e agjenci ne qytete te tjera te Shqiperise ose jashte vendit.

**Neni 3**

**Forma Juridike**



1. Shoqeria eshte shoqeri me pergjegjesi te kufizuar. Veprimtaria e saj i nenshtrohet dispozitave te Aktit te Themelimit, Statutit dhe legjislacionit shqiptar ne fuqi
2. Me vendim te ortakeve mund te ndryshoje formen juridike te Shoqerise, ne qofte se ne te ardhmen krijohen premisa me te favorshme per funksionimin e saj sipas legjislacionit shqiptar. Ne kete rast ortaket do ta pershtasin Aktin e Themelimit dhe Statutin e shoqerise, si dhe do te bejne regjistrimin e saj ne regjistrin tregtar, ne organet kompetente shqiptare.
3. Shoqeria gezon personalitet juridik nga data e regjistrimit te saj ne regjistrin tregtar nga organet kompetente dhe ne perputhje me ligjin.
4. Shoqeria do te kete vulen e saj.

## Kreu II

### TE DREJTAT DHE DETYRAT, KOHEZGJATJA

#### Neni 4

##### Te drejtat e Shoqerise dhe te Ortakut

1. Shoqeria ka te drejte te lidhe marreveshje dhe te nenshkruaje kontrata ne territorin e Shqiperise dhe jashte saj.
2. Shoqeria gezon te drejten te krijojte pasuri materiale dhe intelektuale.
3. Shoqeria ka te drejte te marre pjese si ortak ne nje shoqeri tjeter ose ndermarrje te ndryshme ne Shqiperi ose jashte saj, ne perputhje me legjislacionin shqiptar.
4. Shoqeria pergjigjet ndaj te treteve vetem dhe ekskluzivisht me kapitalin e saj shoqeror te derdhur dhe me te mirat e pasurise se saj.
5. Ortaku merr pjese ne administrimin e veprimtarise se shoqerise ne perputhje me Aktin e Themelimit dhe Statutin, vet ose nepermjet perfaqesuesve te tij.
6. Ortaku ka te drejte te marri te gjitha informatat qe kane te bejne me veprimtarine prodhuese, projektuese, realizuese e tregtare te shoqerise, si bilancet, llogarite ekonomike etj.

#### Neni 5

##### Kohezgjatja

Kohezgjatja e shoqerise eshte me afat te pacaktuar.

## Kreu III

### KAPITALI THEMELTAR

#### Neni 6

##### Kapitali Themeltar

Kapitali themeltar eshte **100.000 (njqind mije) Leke**. 2 (dy) kuota gjithsej.

##### Ortaket e shoqerise jane:

1. **Sahin Tasci**, zotërues i 1 (nje) kuote me vlere 50.000 lek, qe perfaqeson **50% (pesedhjete perqind)** kapitalin themeltar të shoqërisë;
2. **Ramazan Çavur**, zotërues i 1 (nje) kuote me vlere 50.000 lek, qe perfaqeson **50% (pesedhjete perqind)** kapitalin themeltar të shoqërisë;

## Kreu IV

### PERSONALITETI JURIDIK

#### Neni 7

Shoqeria fiton personalitetin juridik ne ditën e regjistrimit të saj në Rregjistrin Tregtar në Qendren Kombëtare të Biznesit, si dhe fillon veprimtarinë e saj me marrjen e licencës të ushtrimit të veprimtarisë.

## **Kreu V ADMINISTRIMI**

### **Neni 8**

Shoqeria do të administrohet nga administratorët **Sahin Tasci** dhe **Ramazan Çavur** të cilet përfaqësojnë shoqërinë në marrëdhëniet me të tretet për një periudhë **5 (pese)** vjeçare dhe me të drejtë rizgjedhje. Të 2 (dy) administratorët përfaqësojnë shoqërinë në marrëdhëniet me të tretet pa qenë të kufizuar në tagrin e tyre, të cilet veç e veç administrojnë dhe përfaqësojnë shoqërinë edhe me bankat e nivelit të dytë me firme personale dhe jo të përbashkët.

Administratorët mund t'i delegojnë kompetencat e tyre me shkrim në formën e autorizimit ose me prokurë.

## **Kreu VI DISPOZITA TË TJERA**

### **Neni 9**


Fitimi i realizuar nga Shoqeria, pas shlyerjes së detyrimeve ligjore, do t'i mbetet Ortakut të saj, ta ndajë si dividend apo ta shtojë në kapitalin e shoqërisë.

Ky Akt shtypet dhe nënshkruhet në 3 (tre) kopje, të gjitha me të njëjten vlerë ligjore.

Një kopje qëndron në dokumentacionin bazë të shoqërisë.

## **Ortaket Themelues**

**Sahin Tasci**

Sahin TASCİ  


**Ramazan Çavur**

Ramazan ÇAVUR  
